



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 6477 Prot

Peshkopi, më 26.09 2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Diber

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për djeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.75

Data: 16.09.2022

“Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,


Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Mikli





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
PREFEKTI I QARKUT DIBËR



Nr.933/1 prot.


Peshkopi, më 26.09.2022

Lenda : Mbi verifikimin e ligjshmërisë të vendimit nr.75 date 16.09.2022

Drejtuar: KESHILLIT BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit *nr.107, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut"*, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e këshillit Bashkisë Dibër, *Nr 75, datë 16.09.2022 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij*, vendosa miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e zbatimit dhe respektimit të legjislacioni aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën social-kulturore, veprime që kurdohet janë përgjegjesi direkte administrative-ligjore e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 75 Datë 16/09/2022

“ Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”.

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr.75/2019 “Për rininë”, me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **16.09.2022**, me 18 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (referuar shkurtimisht KVR) si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Sektori i Arsimit dhe Rinisë, Sektori i Arsimit, Kulturës dhe Turizmit.
3. Vendimi u shpall sot me datë 16.09.2022.

Kryetar Këshilli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
SEKTORI I ARSIMIT KULTURËS TURIZMIT

PROJEKT- VENDIM

Nr. datë 01.08.2022

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË SI DHE MËNYRËS SË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ”

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr.75/2019 “Për rrinë” me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë, I propozohet Këshillit Bashkiak të vendosë :

1. Miratimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (këtu e në vijim referuar shkurtimisht KVR) si dhe të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
2. KVR udhëhiqet nga parimet e gjithëpranuara të ushtrimit të detyrave në përmbushje të interesit publik dhe në veçanti nga parimi I ligjshmërisë,transparencës, mosdiskriminimit,përgjegjshmërisë dhe objektivitetit.
3. KVR përbëhet nga 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) anëtarë ku të respektohet parimi I barazisë gjimore.
4. KVR do të ketë në përbërje :
 - a) Kryetari I Bashkisë, Kryetar I KVR
 - b) Përfaqësues I Këshillit Bashkiak ose administratës (Sektori I Rinisë) së Njësisë Administrative, Anëtar.
 - c) 2 (dy) përfaqësues nga organizatat rinore ose organizata për të rinjtë, (Anëtarë)
 - d) 2 (dy) përfaqësues nga të rinj aktivë të Njësisë Administrative, Anëtarë.
5. Anëtarët e KVR emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe mandati I tyre është 2-vjeçar me të drejtë riemërimi.

takime për më shumë se dy herë radhazi ose në raste të tjera të mospëmbushjes së funksioneve. Anëtari zëvendësohet plotëson mandatin e anëtarit që zëvendëson.

7. Anëtarët e KVR identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirrje për shprehje të interesi për të marrë pjesë në KVR,të hartuar e njoftuar nga Kryetari në fagen zyrtare të institucionit,në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrejet sociale të institucionit.
8. Përzgjedhja mes individëve që kanë shprehur interes nga Këshilli Bashkiak dhe administrata e njësisë administrative bëhet nga Kryetari duke u bazuar në kriterin e përvojës së mëparshme me organizatat jofitimprurëse dhe në projektet që lidhen me të rinjtë.
9. Përzgjedhja mes kandidatve përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë bëhet nga Kryetari dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:
 - a) Të jetë anëtar I një organizate rinore ose për të rinjtë.
 - b) Të mos jetë I dënuar.
 - c) Të ketë përvojë në projekte,nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë.
 - d) T mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimeve në KVR.
10. Kandidatët për KVR,përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë që duhet të aplikojnë brenda afatit dhe në adresën e përcaktuar në njoftimin përkatës duke paraqitur dokumentat e mëposhtme:
 - a) Kërkesë me shkrim, ku të shprehë interesin për aplikim.
 - b) Jetëshkrim
 - c) Fotokopje e dokumenteve që mbështesin shënimet e jetëshkrimit.
 - d) Vërtetim të gjendjes gjyqësore.
 - e) Vetëdeklarim lidhur me shmangien e konfliktit të interesave.
 - f) Referenca nga të paktën 2 (dy) bashkëpunëtorë të mëparshëm.
11. Kandidatët për KVR përfaqësues nga të rinj aktivë të Njesisë Administrative duhet të përmbushin këto kritere:
 - a) Të mos jetë I dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
 - b) Të jetë përfshirë në organizimin apo në zbatimin e aktiviteteve rinore,apo në promovimin e të rinjve.
 - c) Të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në KVR.

dokumentat e mëposhtme :

- a) Kërkesë me shkrim.
 - b) Jetëshkrim (CV).
 - c) Fotokopje të dokumenteve që vërtetojnë jetëshkrimin.
 - d) Vërtetimin e gjenjës gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj.
 - e) Letër interesi/motivimi
 - f) Vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.
13. KVR mblihdhet se 4 (katër) herë në vit. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Kryetari.
14. Veprimtaria e KVR mbështetet nga sekretari teknik që është një punonjës I Bashkisë I ngarkuar nga Kryetari me këtë detyrë.
15. Sekretari teknik njofton anëtarët e KVR jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara për datën dhe orën e takimit si dhe rendin e ditës. Sekretari teknik mban minutat e takimit dhe çdo komunikim tjetër që lidhet me veprimtarinë e KVR.
16. Mbledhjet e KVR zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën 3 (tre) anëtarë. Nëse nuk paraqiten në mbledhje numri minimal I anëtarëve pjesëmarrës, takimi shtyhet për një datë të mëvonshme.
17. Ngarkohet Kryetari I Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

Specialiste e Arsimit dhe Rinisë

Alma LLESHI



Përgjegjëse e Sektorit Arsimit, Kulturës dhe Turizmit

Valbona KALOÇI



Përgjegjëse e Sektorit Juridik

Elona LUSHA



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim MDKLI



KRYETARI

Rahim SPAHIU

